


# Njehsimi diferencial

Derivati: shpejtësia e çastit dhe pjerrtësia

F. M. Berisha



Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

# Qëllimet dhe objektivat

- Kuptimi i npcionit të derivatit të një funksioni, dhe lidhmëria me pjerri të sinë e grafikut dhe shpejtësinë e ndryshimit të funksionit.
- Identifikimi i lidhmërisë ndërmjet derivatit të një funksioni dhe rritjes ose zvogëlimit të tij.
- Zbatimi i derivateve të funksioneve të biznesit në aplikacione
- Njoftimi me simbolikën e shënimit të derivatit

# Përbajtja

## 1 Nocioni i derivatit të një funksioni

- Shpejtësia e çastit e ndryshimit të një funksioni
- Pjerrtësia e lakoresh
- Derivati i një funksioni


## 2 Shembuj

- Shembull ekuacioni tangjente të një grafiku
- Shembull aplikacioni biznesi

## 3 Funksionet e derivueshme

- Disa mënyra shënimisë të derivatit
- Lidhmëria ndërmjet derivueshmërisë dhe vazhdueshmërisë së një funksioni

# Shpejtësia e çastit e ndryshimit të një funksioni



**Figura:** Grafiku i  $f(x)$  me sekantë nëpër pikat  $P(x_0, f(x_0))$  dhe  $Q(x_0 + h, f(x_0 + h))$ .

- Shpejtësia mesatare e ndryshimit të funksionit:


$$v_{\text{mes}} = \frac{f(x_0 + h) - f(x_0)}{h}$$

- Shpejtësia e çastit:

$$v = \lim_{h \rightarrow 0} \frac{f(x_0 + h) - f(x_0)}{h}$$

# Pjerrtësia e tangjentës së lakoresh

- Pjerrtësia e kordës nëpër  $P, Q$ :



**Figura:** Kur  $h \rightarrow 0$  sekantat tentojnë nga tangjenta nëpër  $P$ .

$$\begin{aligned} m_{\text{sec}} &= \frac{f(x_0 + h) - f(x_0)}{(x_0 + h) - x_0} \\ &= \frac{f(x_0 + h) - f(x_0)}{h} \end{aligned}$$

- Pjerrtësia e tangjentës:

$$\begin{aligned} m_{\text{tan}} &= \lim_{h \rightarrow 0} m_{\text{sec}} \\ &= \lim_{h \rightarrow 0} \frac{f(x_0 + h) - f(x_0)}{h} \end{aligned}$$

# Nocioni i derivatit të një funksioni

## Derivati i një funksioni

- *Derivat* i një funksioni  $f(x)$  sipas  $x$  quhet funksioni  $f'(x)$  i dhënë me

$$f'(x) = \lim_{h \rightarrow 0} \frac{f(x + h) - f(x)}{h},$$

kurse procesi i llogaritjes së derivatit quhet *diferencim* (ose *derivim*).

- Themi se  $f(x)$  është *i diferencueshëm* (ose *i derivueshëm*) në  $x_0$  në qoftë se ekziston  $f'(x_0)$ .

# Derivati. Pjerrtësia. Shpejtësia e çastit

## Pjerrtësia. Shpejtësia e çastit

- **Pjerrtësia** e tangjentës së lakoresh  $f(x)$  në pikën  $(x_0, f(x_0))$  jepet me  $m_{\tan} = f'(x_0)$ .
- Shpejtësia e çastit e ndryshimit të madhësisë  $f(x)$  sipas  $x$  kur  $x = x_0$  është e barabartë me  $f'(x_0)$ .

# Shembull ekuacioni tangjente të një grafiku

## Shembull

Llogaritni derivatin e funksionit  $f(x) = x^2$ ,  
pastaj shfrytëzoni rezultatin për të gjetur pjerrtësinë e lakoresh  
në pikën  $x = -1$ .

Cili është ekuacioni i tangjentës në këtë pikë?

# Shembull ekuacioni tangjente të një grafiku. (Vazhdim)

Zgjidhje . . .

Sipas përkufizimit të derivatit

$$\begin{aligned}f'(x) &= \lim_{h \rightarrow 0} \frac{f(x+h) - f(x)}{h} = \lim_{h \rightarrow 0} \frac{(x+h)^2 - x^2}{h} \\&= \lim_{h \rightarrow 0} \frac{(x^2 + 2xh + h^2) - x^2}{h} = \lim_{h \rightarrow 0} \frac{2xh + h^2}{h} \\&= \lim_{h \rightarrow 0} \frac{h(2x + h)}{h} = \lim_{h \rightarrow 0} (2x + h) = 2x.\end{aligned}$$

Pjerrtësia e tangjentës së lakoresh  $y = x^2$  në pikën  $x = -1$ :

$$f'(-1) = 2(-1) = -2$$



# Grafiku i funksionit $y = x^2$




Figura: Tangjenta e lakores  $y = x^2$  në pikën  $(-1, 1)$ .

# Shembull ekuacioni tangjente të një grafiku. (Vazhdim)

... Zgjidhje.

Gjejmë  $y$ -koordinatën e pikës nga e cila është tërhequr tangjenta:

$$y = f(-1) = (-1)^2 = 1.$$

Pra, tangjenta kalon nëpër pikën  $(-1, 1)$  dhe ka pjerrtësinë  $-2$ .  
Ekuacioni i saj:

$$\begin{aligned}y - 1 &= (-2)[x - (-1)] \\y &= -2x - 1.\end{aligned}$$



# Shembull aplikacioni biznesi

## Shembull

Një prodhues vlerëson se kur prodhohen dhe shiten  $x$  njësi  
të një prodhimi të ardhurat e nxjerra do të jenë

$$R(x) = 0.5x^2 + 3x - 2 \text{ mijë euro.}$$

Me çfarë shpejtësie ndryshojnë të ardhurat  
sipas nivelit të prodhimit  $x$  kur prodhohen 3 njësi?

A janë rritëse apo zvogëluese të ardhurat në këtë moment?

# Shembull aplikacioni biznesi. (Vazhdim)

Zgjidhje . . .

Për  $x \geq 0$ , *koeficienti i diferençës* së  $R(x)$  është

$$\begin{aligned} & \frac{R(x+h) - R(x)}{h} \\ &= \frac{[0.5(x+h)^2 + 3(x+h) - 2] - [0.5x^2 + 3x - 2]}{h} \\ &= \frac{[0.5(x^2 + 2xh + h^2) + 3x + 3h - 2] - 0.5x^2 - 3x + 2}{h} \\ &= \frac{xh + 0.5h^2 + 3h}{h} = x + 0.5h + 3. \end{aligned}$$



# Shembull aplikacioni biznesi. (Vazhdim)

... Zgjidhje.

Prandaj, derivati i  $R(x)$  është

$$R'(x) = \lim_{h \rightarrow 0} \frac{R(x + h) - R(x)}{h} = \lim_{h \rightarrow 0} (x + 0.5h + 3) = x + 3,$$

dhe meqë

$$R'(3) = 3 + 3 = 6,$$

rrjedh se të ardhurat ndryshojnë me shpejtësi  $6,000 \text{ €}$  për njësi kur prodhohen 3 njësi.

Meqë  $R'(3) = 6 > 0$ , pra meqë  $R'(3)$  është **pozitiv**, tangjenta në pikën e grafikut të funksionit të të ardhurave për  $x = 3$  duhet të jetë me pjerrtësi përpjetëze.

Vështrimi i tillë na sygjeron se të ardhurat janë rritëse kur  $x = 3$ .



# Grafiku i funksionit të të ardhurave




Figura: Grafiku i lakoresh  $R(x) = 0.5x^2 + 3x - 2$ , për  $x \geq 0$ , me tangjentën në pikën  $x = 3$ .

## Simbolika e shënimit të derivatit

- Derivati  $f'(x)$  i  $y = f(x)$  ndonjëherë shënohet me  $\frac{dy}{dx}$ , kurse vlera e derivatit në  $x = c$  (d.m.th.,  $f'(c)$ ):

$$\left. \frac{dy}{dx} \right|_{x=c}.$$

- Për shembull, në qoftë se  $y = x^2$ , atëherë

$$\frac{dy}{dx} = 2x.$$

- Ndonjëherë fjalia e formës

„në qoftë se  $y = x^2$ , atëherë  $\frac{dy}{dx} = 2x“$

shkurtohet duke shënuar, thjesht,

$$\frac{d}{dx}(x^2) = 2x.$$

# Derivueshmëria dhe vazhdueshmëria e një funksioni

- Nëse një funksion është i derivueshëm në një pikë  $P(x_0, f(x_0))$ , atëherë grafiku i tij ka tangjentë jovertikale në pikën  $P$ , të cilës i „ofrohen“ të gjitha pikat e grafikut në „afërsi“ të  $P$ .
- Intuitivisht, një gjë e tillë sygjeron se një funksion duhet të jetë i vazhdueshëm në çdo pikë ku është i derivueshëm, meqë grafiku nuk mund të ketë „vrimë“ ose „këputje“ në ndonjë pikë ku mund të tërhiqet tangjenta.
- Mirëpo, e anasjelltë nuk është e vërtetë; d.m.th., një funksion i vazhdueshëm nuk është e thënë të jetë edhe i derivueshëm.

## Udhëzime për lexim të mëtejjmë

- <http://fberisha.netfirms.com>
- **Detyrë shtëpie:** Detyrat për ushtrime nga materiali mësimor.
- F. M. Berisha, M. Q. Berisha, *Matematikë – për biznes dhe ekonomiks*, fq. 153–161.
- L. D. Hofmann, G. L. Bradley, *Calculus – for business, economics and life sciences*, fq. 98–109.

# Përfundim

- Ekuivalenca e konceptit të derivatit të një funksioni me pjerrtësinë e grafikut dhe shpejtësinë e ndryshimit të funksionit.
- Lidhmërisë ndërmjet parashenjës së derivatit të një funksioni dhe rritjes ose zvogëlimit të tij.
- Simbolika e shënimit të derivatit:

$$f'(x) = \frac{d}{dx} f(x)$$
$$f'(c) = \left. \frac{df(x)}{dx} \right|_{x=c} .$$